

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

P.Nr. 542/11

Data: 26 Korrik 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, në trupin gjykues të përberë nga Gjyqtari i EULEX-it Ingo Risch si Kryetar i Trupit Gjykues, Gjyqtarja Lumturije Muhaxheri dhe Gjyqtari Gezim Pozhegu si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Procesmbajtësi Joseph Hollerhead, në rastin penal kundër,

SHK, i biri i I dhe B, mbiemri i vajzërisë Xh, i lindur me 16 Prill 1961 në fshatin të Komunës së Pejës, banon në rrugën “*****” nr.***, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme financiare, i martuar dhe ka katër fëmijë, Shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës.

XHK, i biri i Sh dhe F, mbiemri i vajzërisë S, i lindur me ***** në Pejë, banon në rrugën “*****” nr.*****, i papunë, e ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme financiare, i martuar dhe ka një fëmijë, Shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës.

VK, i biri i Sh dhe F, mbiemri i vajzërisë S, i lindur me ***** në Pejë, banon në rrugën “*****” nr.*****, punëtor, e ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme financiare, i pa martuar dhe nuk ka fëmijë, Shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës.

Të akuzuar me Aktakuzën e Zyrës së Prokurorisë speciale PP.nr. 387/06, e datës 26 Mars 2007, për veprat penale të *Bashkimit Kriminal* sipas Nenit 26 në lidhshmëri me Nenin 23 të KPK-së në lidhje me veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* sipas Nenit 147, par 1, pika 9 e KPK-së, dhe vepra penale e *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas Nenit 328, par 2 i KPK-së.

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor të cilat kanë qenë të hapura për publik me datat 07 Maj, 26 Qershor dhe 26 Korrik 2012, në prani të Prokurorit të EULEX-it Peter Korneck, me datë 07 Maj 2012, Prokurori publik Ali Uka, të akuzuarve SHK, XHK dhe VK, avokatët e tyre mbrojtës Zenel Mekaj, Haxhi Cekaj dhe Nushe Kuka Mekaj,

Pas shqyrtimit dhe votimit të trupit gjykues, me datë 26 Korrik 2012, shpall publikisht si në vijim;

AKTGJYKIM

I.

Sipas Nenit 390, par 1, pika 3 e KPPK-së, të akuzuarit **SHK, XHK dhe VK** (*me të dhëna personale si më lartë*),

LIROHEN

Nga kryerja e veprës penale të *Bashkimit Kriminal* sipas Nenit 26, në lidhshmëri me Nenin 23 të KPK-së, në lidhje me veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* sipas Nenit 147, par 1, pika 9 e KPK-së, sepse nuk është vërtetuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën për të cilën janë akuzuar nën Pikën I të Aktakuzës.

II.

Sipas Nenit 390, par 1, pika 3 e KPPK-së, i akuzuari **XHK**,

LIROHET

Nga kryerja e veprës penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Nenit 328, par 2 i KPK-së, sepse nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet nën Pikën III të Aktakuzës.

Në bazë të Nenit 103, par 1 i KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale do paguhet nga mjetet buxhetore të Kosovës.

Arsyetimi

Sfondi Procedural

Me datë 07 Maj 2007, Zyra e Prokurorisë Speciale në Prishtinë ka parashtruar një aktakuzë PP.nr. 387/06 PPHQ.nr. 87/06, të datës 26 Mars 2007, kundër KH, AK, SHK, XHK dhe VK për veprat penale të *Bashkimit Kriminal* sipas Nenit 26 në lidhshmëri me Nenin 23 të KPK-së, në lidhshmëri me veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* sipas Nenit 147, par 1, pika 9 e KPK-së, veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* sipas Nenit 147, par 1, pika 4 e KPK-së dhe veprën penale *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas Nenit 328, par 2 i KPK-së.

Aktakuza është konfirmuar me datë 14 Qershor 2007 nga gjyqtari për konfirmim të aktakuzës i Gjykatës së Qarkut në Pejë përmes Aktvendimit KAQ.nr. 133/07.

Shqyrtimi i parë gjyqësor në rastin numër P.nr. 583/07 është mbajtur me datat 15, 16, 17, 18 Tetor, 19 Nëntor, 17 dhe 18 dhjetor 2007. Me datë 18 Dhjetor 2007, është shpallur aktgjykimi duke i liruar të gjithë të pandehurit për veprën penale të *Bashkimit Kriminal* sipas Nenit 26 në lidhshmëri me Nenin 23 të KPK-së, në lidhshmëri me veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* sipas Nenit 147, par 1, pika 9 e KPK-së. Më tej, i pandehuri KH është liruar nga vepra penale e *Vrasjes së Rëndë* sipas Nenit 147, par 1, pika 4 e KPK-së dhe i pandehuri XhK është liruar nga vepra penale e *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas Nenit 328, par 2 i KPK-së.

Të pandehurit KH dhe AK janë gjetur fajtor për veprën penale të *Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas Nenit 328, par 2 i KPK-së dhe secili është dënuar me nga një vit e katër muaj burgim.

Me datë 27 Tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur mbi ankesën e Prokurorit Publik, e ka aprovuar ankesën dhe e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë që ka të bëjë me pjesën e shfajësimit dhe e ka dërguar rastin për rishqyrtim. Tek pjesa mbi dënimin, aktgjykimi i shkallës së parë është konfirmuar.

Në rigjykim rastit i është caktuar numri P.nr. 542/11.

Me datë 29 Shkurt 2012, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, duke vendosur në bazë të kërkesës së Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, pas shqyrtimit të mbajtur me datë 16 Shkurt 2012, ka vendosur për ta marrë rastin dhe të ia caktojë në kompetencë gjyqtarëve të EULEX-it për procedim të mëtejshëm. Sipas këtij vendimi rasti i është caktuar një gjyqtari të EULEX-it dhe dy gjyqtarëve vendor të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Me datë 07 Maj 2012, ka vazhduar rigjykimi. Sidoqoftë, të dy të pandehurit nga Republika e Shqipërisë, KH dhe AK, nuk janë paraqitur. Nga dosja e rastit ka rezultuar se ata nuk janë ftuar sipas rregullit. Andaj, Kryetari i trupit gjykues me datë 07 Maj 2012 ka lëshuar një letër porosi tek autoritetet relevante të Republikës së Shqipërisë, përmes Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës si organ kompetent për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar. Shqyrtimi kryesor është shtyrë për datën 27 Qershor 2012.

Gjer në datën 27 Qershor 2012 nuk ka pasur përgjigje nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë. Kështu që, për të mos bërë shkeljen e të drejtave të të tre pandehurve në Kosovë, të ShK, XhK dhe VK, trupi gjykues ka vendosur që ta ndajë dosjen e rastit në mes të të tre të pandehurve të fundit dhe atyre dy të tjerëve, duke pasur parasysh që janë në Shqipëri. Më tej, trupi gjykues ka vendosur që të lëshoj një urdhër arresti, një urdhër për lëshimin e një letër rreshtimi dhe një kërkesë për një letër rreshtim ndërkombëtar kundër dy të pandehurve.

Me 24 Korrik 2012, gjykata ka pranuar një përgjigje nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës në lidhje me tentimin për ta ftuar KH dhe AK.

Sipas këtij raporti, vëllai i KH ka theksuar se K banon në Angli. Në lidhje me AK, vëllai i tij ka theksuar se ai jeton në Kosovë, por nuk ka adresë.

Në bazë të kësaj rrethane, gjykata gjen se ndarja e rastit është e drejtë dhe vazhdon gjykimin me tre të pandehurit që janë në Kosovë, meqë raporti i Ministrisë së Drejtësisë përafërsisht bazohet në pohimet e vëllezërve të të dy të pandehurve nga Shqipëria në lidhje me vendndodhjen e tyre.

Kompetencat dhe Përbërja e Trupit Gjykes

Në përputhje me Nenin 23, par 1 i KPPK-së, Gjykatat e Qarkut do kenë juridiksionin për të gjykuar, në shkallë të parë, veprat penale të dënueshme me së paku pesë vite burgim ose me burgim afatgjatë.

Në këtë rast, akuza kundër të pandehurve është *Bashkimi Kriminal* sipas Nenit 26, në lidhshmëri me Nenin 23 të KPK-së, në lidhshmëri me veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* sipas Nenit 147, par 1, pika 9 e KPK-së, me burgim prej së paku dhjetë (10) vitesh. Andaj, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka kompetencën lëndore për ta gjykuar rastin.

Vepra penale sipas aktakuzës është kryer në fshatin Baic të Komunës së Istogut e cila është brenda territorit të Qarkut të Pejës. Andaj, në përputhje me Nenin 27, par 1 i KPPK-së, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka juridiksionin territorial që ta gjykojë këtë rast.

Meqë ky rast i është caktuar në kompetencë Gjyqtarëve të EULEX-it me vendimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it me datë 29 Shkurt 2012, trupi gjykes është përbërë nga një Gjyqtar i EULEX-it dhe dy Gjyqtarë Kosovar sipas Nenit 3.7 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Asnjëra nga palët nuk e ka kundërshtuar përbërjen e trupit gjykes.

Seancat e Shqyrtimit Kryesor

Shqyrtimi kryesor është mbajtur i hapur për publik me datë 26 Korrik 2012 në prani të Prokurorit Publik Ali Uka, të akuzuarve ShK, XhK dhe VK dhe avokatëve të tyre mbrojtës Zenel Mekaj, Haxhi Cekaj dhe Nushe Kuka Mekaj.

Pala e dëmtuar VI nuk ka qenë i pranishëm.

Në përputhje me Nenin 15 të KPPK-së, përkthyesit ndërkombëtar kanë përkthyer në seancat gjyqësore dhe të gjitha dokumentet gjyqësore relevante për gjykimin nga Gjuha Angleze në Gjuhën Shqipe dhe e kundërta, simbas nevojës.

Dëshmitë e administruara gjatë shqyrtimit kryesor

Gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor, trupi gjykues, me pajtimin e palëve, i ka konsideruar si të lexuara deklaratat në vijim:

Deklarata e dëshmitarit *VI* e dhënë para Prokurorit me datë 24 Gusht 2006.

Deklarata e dëshmitarit *VI* e dhënë në Polici me datë 20 Gusht 2006.

Deklarata e dëshmitarit *ST* e dhënë në Polici me datë 20 gusht 2006.

Dëshmia e dëshmitarit ekspert të Balistikës *ÇH* e dhënë para trupit gjykues me datë 16 Tetor 2007.

Dëshmia e dëshmitarit ekspert të forenzikës *AG* e dhënë para trupit gjykues me datë 16 Tetor 2007.

Deklarata e të pandehurit *XhK* e dhënë para Prokurorit me datë 27 Shkurt 2007.

Deklarata e të pandehurit *XhK* e dhënë para Prokurorit me datë 16 Mars 2007.

Deklarata e të pandehurit *VK* e dhënë para Prokurorit me datë 28 Shtator 2006.

Deklarata e të pandehurit *VK* e dhënë në Polici me datë 22 Gusht 2006.

Deklarata e të pandehurit *ShK* e dhënë para Prokurorit me datë 28 Shtator 2006.

Deklarata e të pandehurit *ShK* e dhënë para Prokurorit me datë 16 Mars 2007.

Deklarata e të pandehurit *ShK* e dhënë para Prokurorit me datë 22 Gusht 2006.

Deklarata e të pandehurit *AK* e dhënë para Prokurorit me datë 12 Shtator 2006.

Deklarata e të pandehurit *AK* e dhënë para Prokurorit me datë 28 Shtator 2006.

Deklarata e të pandehurit *AK* e dhënë para Prokurorit me datë 20 Tetor 2006.

Deklarata e të pandehurit *AK* e dhënë në polici me datë 20 Gusht 2006.

Dëshmia e të pandehurit *KH* e dhënë para trupit gjykues me datë 17 Tetor 2007.

Deklarata e të pandehurit *KH* e dhënë para Prokurorit me datë 12 Shtator 2006.

Deklarata e të pandehurit *KH* e dhënë para Prokurorit me datë 28 Shtator 2006.

Deklarata e të pandehurit *KH* e dhënë para Prokurorit me datë 01 Nëntor 2007.

Deklarata e të pandehurit *KH* e dhënë në Polici me datë 21 Gusht 2006.

Deklarata e të pandehurit *KH* e dhënë në Polici me datë 22 Gusht 2006.

Dëshmitë e dokumentuara

1. Raporti nga vendi i krimit 2006-DI-352 i datës 20 Gusht 2006 së bashku me skicën nga vendi i krimit dhe disa fotografi të lokacionit ku janë gjetur pistoleta dhe pushka automatike AK-47.

2. Raporti Balistik numër 2006-1917 i datës 20 Nëntor 2006.
3. Raporti mbi ekzaminimin e shenjave të gishtërinjve numër 2006-1917 i datës 31 Tetor 2006.
4. Flete lëshimi me Epikrizë në lidhje me viktimën JO i lëshuar nga Spitali i Prishtinës numri i protokollit 375 i datës 20 Gusht 2006.

Gjetjet Faktike

Trupi gjykues gjen se herët në mëngjesin e datës 20 Gusht 2006, në ora 05:45 min, në fshatin Bajice të Komunës së Istogut, JO është qëlluar dy herë nga KH me një armë zjarri, një herë në kokë dhe një herë në gjoks, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse, nga të cilat plagë i cekuri JO ka vdekur me datë 22 Gusht 2006 në një spital të Zvicrës. Duke vepruar në atë mënyrë, KH po ashtu ka qëlluar dhe e ka lënduar AB në supin e tij të majtë.

Të shtënat ndodhën sepse viktimja JO dhe AB kanë dashur që ta kapin të pandehurin KH meqë ata kanë menduar se ai ka qenë në atë rajon për ti vjedhur fshatarët. JO dhe AB veq e kishin nxënë AK dhe e kanë dorëzuar në polici.

Të pandehurit ShK, VK dhe XhK nuk kanë pasur të bëjnë asgjë me këtë vrasje. Nuk ka pasur dëshmi se viktimja dhe tre të pandehurit e përmendur kanë pasur ndonjë grindje mes vete e as që kanë pasur ndonjë lidhje me njëri tjetrin.

Vlerësimi i dëshmive

Nga dëshmitë që trupi gjykues i ka pasur në dispozicion, në lidhje me të pandehurit ShK, VK dhe XhK, faktori i vetëm inkriminues është deklarata e KH dhe një pjesë e deklaratës së AK.

Në të gjitha deklaratat e tija KH ka sqaruar se ai ka ardhur në Kosovë me AK dhe AD në mënyrë që ta kryejnë një vrasje për ShK. Ai tha që atij i janë ofruar 5000€ që ta kryej këtë vrasje. Personi që ai duhej ta vriste ka qenë pronar i një makine të tipit BMW me ngjyrë hiri dhe me tabela të huaja të regjistrimit. Ai i ka marrë armët nga të dy djemtë e ShK, VK dhe XhK. Ai ka qenë së bashku me AK kur ata janë dërguar me makinë në vendin se ku do bëhej prita. Sidoqoftë, fshatarët i kanë vërejtur ata dhe ata kanë filluar që ti ndjekin ata. Ai është ndarë nga AK me atë rast. Ai ka shkuar që të fshihej në një arë me misër dhe ka qëndruar atje deri në perëndim të diellit. Pastaj ai ka shkuar në rrugën kryesore ku ai do ta takonte viktimën JO dhe AB. Ata janë përpjekur që ta ndalojnë atë megjithatë ai arrin që të largohet. Në atë moment ai ka dëgjuar që JO e ka nxjerr dhe e ka repetuar armën dhe ka gjuajtur dy herë në drejtim të tij. Në vrapim e sipër, ai e ka nxjerr armën e tij dhe ka filluar të gjuaj në drejtim të JO.

AK ka qëndruar në heshtje gjatë shqyrtimit kryesor. Në deklaratën e tij të mëparshme të dhënë në polici ai ka sqaruar se ai ka ardhur në Kosovë me KH dhe AD. Ai tha që Agim Demiraj u ka thënë atyre se ata do të shkonin në Kosovë për të gjetur punë. Kur ata kanë ardhur në Kosovë, AD u ka thënë që ata do e kryejnë një vrasje për ShK. Ata janë takuar me ShK tek shtëpia e Sh në Pejë. Së bashku me djemtë e Sh, V dhe Xh ai ka shkuar në qendër të qytetit që ta identifikojnë veturën BMW me tabela regjistrimi të Francës 1578 SM 33, pronari i së cilës është personi të cilin ata duhet që ta vrasin. Ai ka qenë së bashku me KH kur ai është dërguar tek vendi ku duhej të bëhej prita. Më vonë ata janë vërejtur nga dy fshatarë. Fshatarët i kanë pyetur ata se çfarë ishin duke bërë aty dhe po ashtu u kanë kërkuar pasaportat e tyre. Në atë moment ai ka filluar që të ik nga ata. Ai është ndarë nga KH. Më vonë një makinë ia ka prerë rrugën dhe dy burra kanë dalur jashtë dhe kanë urdhëruar që të futet në makinë. Ai është dërguar në shtëpinë e njërit nga fshatarët. Ai është pyetur se çfarë kërkonte në atë fshat. Ai është kërcënuar me një armë gjuetie nga njëri nga ata persona. Pastaj, ai është dërguar në stacionin policor në Istog ku e ka kaluar natën. Herët në mëngjes ai është liruar. Ai ka auto stopuar një makinë Opel në drejtim të Pejës. Kur ai ka arritur në fshatin Bajice ai ka vërejtur policë gjithandej. Ka qenë aty ku ai është arrestuar.

Nga deklarata e VI është konkluduar se ai ka qenë pronari i makinës BMW 530 me tabela Franceze 1578ST 33. Ai ka deklaruar se ai jeton në Francë. Ai nuk ka pasur asnjëherë probleme me familjen K. Ai e njeh ShK dhe ai nuk ka pasur probleme me të. Ai nuk i njeh dy djemtë e ShK personalisht; megjithatë ai e di se kush janë ata.

Trupi gjykues nuk ka qenë në gjendje ti vlerësojë siç duhet deklaratat e dy të pandehurve KH dhe AK në mungesë të tyre. Mund të ketë të vërteta në pretendimet e tyre. Sidoqoftë, gjykata ka dyshime në lidhje me deklaratat e tyre. Nuk ka dëshmi që të mbështesë pretendimet e tyre. Megjithatë, krimi për të cilin ata ishin kontraktuar që ta kryejnë, nuk është kryer asnjëherë. Ka qenë rastësisht që KH ka hasur në personin tjetër kur kanë ndodhur të shtënat. Dhe meqë rasti është ndarë nga kjo akuzë, kjo qështje nuk është vlerësuar në këtë rast.

Është e mundur që një rast *aberration ictus* ka ndodhur kur është sulmuar caku i gabuar. Por, nuk ka dëshmi objektive për ta mbështetur një supozim të tillë.

Si pasojë, tre të pandehurit ShK, VK dhe XhK duhet që të lirohen nga të gjitha akuzat në Aktakuzë.

Shpenzimet e procedurës penale

Meqë të gjithë të pandehurit janë liruar, sipas Nenit 103, par 1 i KPPK-së, shpenzimet e procedurave penale do paguhën nga mjetet buxhetore të Republikës së Kosovës.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË
P.nr. 524/11

E datës 26 Korrik 2012

Anëtare e trupit gjykues

Anëtar i trupit gjykues

Kryetar i trupit gjykues

Lumturije Muhaxheri

Gezim Pozhegu

Ingo Risch

Procesmbajtës

Joseph Hollerhead

Këshillë Ligjore:

Personat e autorizuar mund të parashetrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi dhe atë përmes Gjykatës së Qarkut në Pejë për Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kopja e aktgjykimit u është shërbyer palëve, sipas Nenit 398, Par 1 i KPPK-së.